

Fusha Evropiane e Arsimit të Lartë Arritja e qëllimeve

**Komunikata e konferencës së
Ministrave Evropian përgjegjës për Arsimin e Lartë
19-20 Maj 2005, Bergen**

Ne, ministrat përgjegjës për arsimin e lartë në shtetet pjesëmarrëse të procesit të Bolonjës, jemi mbledhur për një rishikim afat mesëm dhe për të caktuar synimet dhe prioritetet për 2010. Në këtë konferencë, ne kemi mirëpritur Armeninë, Azerbajxhanin, Gjeorgjinë, Moldavinë dhe Ukrainën si vende të reja pjesëmarrëse në procesin e Bolonjës. Të gjithë ne kemi një mirëkuptim të përbashkët të parimeve, objektivave dhe angazhimeve të Procesit siç është theksuar në Deklaratën e Bolonjës dhe në komunikatat nga Konferencat Ministrore në Pragë dhe Berlin. Ne konfirmojmë angazhimin tonë në koordinimin e politikave tona përmes procesit të Bolonjës për të ndërtuar fushën Evropiane të arsimit të lartë (EHEA) deri në vitin 2010, dhe zotohemi që të ndihmojmë vendet e reja pjesëmarrëse për zbatimin e qëllimeve të procesit.

I. Partneriteti

Ne nënvizojmë rolin kryesor të institucioneve të arsimit të lartë, stafin e tyre dhe studentët si partnerë në procesin e Bolonjës. Roli i tyre në zbatimin e procesit po bëhet gjithnjë më i rëndësishëm për reformat legjislative janë kryesisht të vendosura dhe ne i inkurajojmë ata për të vazhduar dhe rritur përpjekjet e tyre për krijimin Fushën Evropiane të arsimit të lartë. Ne mirëpresim angazhimin e qartë të institucioneve të arsimit të lartë në Evropë, dhe ne njohim nevojën për të optimizuar ndikimin e ndryshimit strukturor për plan-programet dhe në këtë mënyrë për të siguruar hyrjen e proceseve inovative të mësimdhënies dhe mësimnxënies të cilat kërkohen nga Evropa.

Ne mirëpresim mbështetjen e organizatave që përfaqësojnë biznesin dhe partnerët social dhe shpresojmë të kemi bashkëpunim më të madh në arritjen e qëllimeve të procesit të Bolonjës. Ne gjithashtu mirëpresim kontributet e institucioneve ndërkombëtare dhe organizatave që janë partnere në Proces.

II. Mbështetja

Vëmendje të veçantë i kushtojmë progresit të rëndësishëm për qëllimet tona, të caktuara në Raportin e Përgjithshëm 2003-2005 nga Grupi Pasues, Raporti IV i Trends të Shoqatës të Universiteteve Evropiane (EUA) dhe raporti ESIB (Bashkimi Kombëtar i Studentëve të Evropës) *Bolonja nga pikëpamja e studentëve*.

Në takimin tonë në Berlin, ne i kërkuam Grupin Pasues për një mbështetje afatmesëm, duke u përqendruar në tri prioritete – sistemi i nivelit, sigurimi i cilësisë dhe njohja e kualifikimeve dhe periudhat e studimit. Nga ky raport ne vërejmë se është bërë progres substancial në tri fusha prioritare. Me rëndësi është që të sigurohet që progresi të jetë në përputhje me të gjitha vendet pjesëmarrëse. Andaj, ne shohim nevojën për një ekspertizë më të madhe të përbashkët për ndërtimin e kapaciteteve në nivel institucional dhe qeveritar.

Sistemi i gradave

Ne theksojmë me kënaqësi që sistemi i gradave në dy ciklet është duke u zbatuar në shkallë të gjerë nga më shumë se gjysma e studentëve që janë regjistruar në shumicën e vendeve. Megjithatë, ekzistojnë ende disa pengesa për t'iu qasur cikleve. Përveç kësaj, ekziston nevoja për një dialog më të gjerë duke përfshirë qeveritë, institucionet dhe partnerët social për ta rritur numrin e punësimit të të diplomuarve me kualifikimet bachelor duke përfshirë postet e nevojshme brenda shërbimeve publike.

Ne do të adoptojmë kornizën për kualifikime në EHEA, që përbëhet nga tri cikle (përfshirë kontekstet nacionale, mundësia e kualifikimeve e ndërmjetme), përshkruesit gjenerik për secilin cikël duke u bazuar në rezultatet dhe kompetencat e të mësuarit dhe vendosja e kreditave në ciklin e parë dhe të dytë. Ne zotohemi në elaborimin e kornizave nacionale për kualifikime në pajtim me kornizën për kualifikime në EHEA deri në vitin 2010 me fillim nga viti 2007. Ne kërkojmë nga Grupi pasues të raportojë mbi zbatimin dhe zhvillimet e mëtutjeshme të kornizës.

Ne nënvizojmë rëndësinë e sigurimit të plotësimit të kornizës për EHEA dhe kornizës më të gjerë të propozuar për kualifikime për mësimin gjatë gjithë jetës duke përfshirë arsimin e përgjithshëm si dhe aftësimin dhe trajnimin profesional, që po zhvillohet në Bashkimin Evropian, si dhe në mesin e vendeve pjesëmarrëse. Ne kërkojmë nga Komisioni Evropian që të konsultojë të gjitha palët e Procesit të Bolonjës lidhur me progresin.

Sigurimi i cilësisë

Pothuaj të gjitha shtetet kanë bërë dispozitën për një sistem të sigurimit të cilësisë në bazë të kriterëve të caktuar në Komunikatën e Berlinit dhe me një nivel të lartë të bashkëpunimit dhe rrjetit.

Megjithatë, ende duhet arritur progres, në veçanti përfshirja e studentëve dhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Përveç kësaj, ne nxisim institucionet e arsimit të lartë për vazhdimin e përpjekjeve të tyre për ta ngritur cilësinë e aktiviteteve të tyre përmes hyrjes sistematike të mekanizmave të brendshme dhe korrelacionit direkt të sigurimit të jashtëm të cilësisë.

Ne do t'i adoptojmë standardet dhe udhëzimet e sigurimit të cilësisë në fushën Evropiane të arsimit të lartë të propozuar nga ENQA. Ne zotohemi në paraqitjen e modelit të propozuar për një rishikim të përbashkët të agjencive për sigurimin e cilësisë mbi baza nacionale, duke respektuar udhëzimet dhe kriteret e përbashkëta. Ne mirëpresim parimin e regjistrimit Evropian të agjencive për sigurimin e cilësisë në bazë të rishikimit nacional. Ne kërkojmë që praktikatat e zbatimit të zhvillohen edhe më tej nga ENQA në bashkëpunim me EUA, EURASHE dhe ESIB me një raport kthyes përmes Grupit Pasues. Ne theksojmë rëndësinë e bashkëpunimit në mes agjencive nacionale me një pikësynim të rritjes së njohjes së përbashkët të akreditimit apo vendimeve të sigurimit të cilësisë.

Njohja e gradave dhe periudhat e studimit

Ne theksojmë se 36 nga 45 vendet pjesëmarrëse tani e kanë ratifikuar Konventën e Njohjes së Lisbonës. Ne nxisim ata të cilët ende nuk e kanë miratuar atë, pra ta miratojnë Konventën pa u vonuar. Ne zotohemi që të sigurojmë zbatimin e plotë të parimeve të saj dhe të inkorporimit i tyre në legjislacionin nacional. Ne apelojmë tek të gjitha vendet pjesëmarrëse që të përqendrohen në problemet e njohjes së diplomave të identifikuara nga rrjetet ENIC/NARIC. Ne do të bëjmë plane nacionale të veprimit për të përmirësuar cilësinë e procesit të asociuar me njohjen e kualifikimeve të huaja. Këto plane do të formojnë pjesën e raportit të secilit vend për Konferencën e ardhshme ministrore. Ne shprehim mbështetje për tekstet shtesë të Konventës së Lisbonës dhe apelojmë tek të gjitha autoritetet dhe palët tjera të interesuara që ti njohin gradët e përbashkëta të cilat fitohen në dy apo më shumë vende në EHEA.

Ne i shohim zhvillimet nacionale dhe kornizat Evropiane për kualifikime si një mundësi për mësimin të vazhdueshëm gjatë gjithë jetës në arsimin e lartë. Ne do të punojmë me institucionet e arsimit të lartë dhe të tjerat për të përmirësuar njohjen paraprake të mësimin duke përfshirë, ku është e mundur, mësimin joformal dhe informal për qasjen si elemente në programet e arsimit të lartë.

III. Sfidat dhe prioritetet e mëtejshme

Arsimi i lartë dhe kërkimet shkencore

Ne theksojmë rëndësinë e arsimit të lartë në rritjen e kërkimeve të mëtutjeshme dhe rëndësinë e kërkimeve shkencore në përforcimin e arsimit të lartë për zhvillime ekonomike dhe kulturore të shoqërive tona dhe kohezionit social. Ne theksojmë se të gjitha përpjekjet për ta bërë ndryshimin strukturor dhe përmirësimin e cilësisë së të mësuarit nuk do të hiqet nga përpjekja për fuqizimin e kërkimeve dhe inovacionit. Andaj, ne theksojmë rëndësinë e kërkimeve dhe trajnimit për kërkime shkencore në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e konkurrencës dhe atraktivitetin e EHEA. Me një pikësynim për të arritur rezultate më të mira, ne njohim nevojën për përmirësimin e sinergjisë në mes sektorit të arsimit të lartë dhe sektorëve tjerë për kërkime nëpër vendet tona përkatëse dhe në mes EHEA dhe Fushës Evropiane për kërkime shkencore.

Për ti arritur këto objektiva, kualifikimet e nivelit të doktoraturës duhet të radhitet me kornizën të EHEA për kualifikime duke përdorë qasjen e rezultateve bazë. Komponenti bërthamë i trajnimit të doktoraturës është përparimi i njohurive përmes kërkimeve origjinale. Duke konsideruar nevojën për programet e strukturuar të doktoraturës dhe nevojën për mbikëqyrje dhe vlerësim transparent, ne vërejmë ngarkesën e punës të ciklit të tretë në shumicën e vendeve që korrespondon me 3-4 vite të plota. Ne kërkojmë nga universitetet që të sigurojnë që programet e tyre të doktoraturës të promovojnë trajnime ndërdisiplinore dhe zhvillime të aftësive të transferueshme, dhe në këtë mënyrë plotësohen kërkesat e tregut më të gjerë të punësimit. Ne duhet të arrijmë një rritje të përgjithshme në numrin e kandidatëve të doktoraturës të cilët bëjnë kërkime në karrierë në EHEA.

Ne marrim në konsideratë pjesëmarrësit në programet e ciklit të tretë si studentë dhe si kërkues të fazës së hershme. Ne kërkojmë nga Grupi Pasues i Bolonjës të fton Shoqatën e Universiteteve Evropiane (European University Association), së bashku me partnerët tjerë të interesuar ta përgatisin një raport sipas përgjegjësisë së Grupit Pasues për zhvillimet e mëtutjeshme të parimeve bazike për programet e doktoraturës, tu prezantohen Ministrave në 2007. Mbirregullimi i programeve të doktoraturës duhet të shmanget.

Dimensioni social

Dimensioni social i procesit të Bolonjës është një pjesë përbërëse e EHEA dhe konditë e nevojshme për atraktivitetin dhe konkurrencën e EHEA. Andaj, ne përsërisim zotimin tonë që ta bëjmë cilësinë e arsimit të lartë të arritshëm për të gjithë dhe theksojmë nevojën për kushtet e përshtatshme për studentët në mënyrë që ata të përfundojnë studimet e tyre pa ndonjë pengesë lidhur me historikun e tyre social dhe ekonomik. Dimensioni social përfshinë masat që ndërmerren nga qeveritë për ti ndihmuar studentët, sidomos ata nga grupet me gjendje sociale të rëndë, në aspekte financiare dhe ekonomike dhe për ti ofruar shërbime udhëzuese dhe konsultuese me një synim të qasjes më të gjerë.

Mobiliteti

Ne njohim se lëvizshmëria e studentëve dhe stafi në mesin e të gjitha vendeve pjesëmarrëse mbetet një ndër objektivat kyçe të Procesin të Bolonjës. Të vetëdijshëm për sfidat e mbetura që duhet të tejkalohen, ne ripohojmë zotimin tonë për lehtësimin e mbartshmërisë të granteve dhe kredive ku është e nevojshme përmes veprimit të përbashkët, me synimin që lëvizshmëria brenda EHEA të bëhet realitet.

Ne do të bëjmë përpjekje edhe më të fuqishme që largojmë pengesat drejt lëvizshmërisë duke lehtësuar shpërndarjen e vizave dhe lejimit të punës dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen në programet e lëvizshmërisë. Ne inkurajojmë institucionet dhe studentët që ti shfrytëzojnë programet e lëvizshmërisë, mbrojtjen dhe mbështetjen e njohjes së periodave të studentëve jashtë vendit në programe të tilla.

Atraktiviteti i EHEA dhe bashkëpunimi me pjesët tjera të botës

Fusha Evropiane e Arsimit të Lartë duhet të jetë e hapur dhe duhet të jetë atraktive për të gjitha vendet e botës. Kontributi i jonë për arritjen e arsimit për të gjithë duhet të jetë i bazuar në parimin e zhvillimeve të qëndrueshme dhe të jetë në pajtim me punën e vazhdueshme ndërkombëtare për udhëzimet zhvilluese për dispozitën e cilësisë të arsimit të lartë ndër-kufitar. Ne përsëritshëm theksojmë se duhet të ekzistojë bashkëpunimi ndërkombëtar akademik dhe vlerat akademike.

Ne e shohim Fushën Evropiane të Arsimit të Lartë si partnere e sistemeve të arsimit të lartë në rajonet tjera të botës, duke stimuluar këmbimin dhe bashkëpunimin e balancuar të studentëve dhe stafit në mes të institucioneve të arsimit të lartë. Ne nënvizojmë rëndësinë në ngritjen e mirëkuptimit të procesit të Bolonjës në kontinentet tjera duke këmbyer

përvojat tona për proceset reformuese me vendet fqinje. Ne theksojmë nevojën për dialog mbi çështjet me interes të përbashkët. Ne shohim nevojën e identifikimit të rajoneve partnere dhe fuqizimit të këmbimit të ideve dhe përvojave me ato rajone. Ne kërkojmë nga Grupi Pasues që të elaborojë dhe të pajtohet me strategjinë për dimension të jashtëm.

IV. Takingstock on progress for 2007

Ne kërkojmë nga Grupi Pasues për vazhdimin dhe zgjerimin e procesit dhe raportimin me kohë për Konferencën e ardhshme Ministrore. Ne presim që veprimtaria vazhduese të bazohet në metodologjinë e përshtatshme dhe të vazhdojë në fushat e sistemit të gradës, sigurimit të cilësisë dhe njohjen e gradave dhe periudhave të studimit dhe deri në vitin 2007 ne duhet ti zbatojmë tri prioritetet të ndërmjetme si në vijim:

Në veçanti, ne do të kërkojmë progresin në:

- Zbatimin e standardeve dhe udhëzimeve për sigurimin e cilësisë siç është propozuar në raportin e Rrjetit Evropian të Sigurimit të Cilësisë (ENQA);
- Zbatimin e kornizave nacionale për kualifikime;
- Dhënia dhe njohja e gradave të përbashkëta, duke përfshirë nivelin e doktoraturës;
- Krijimi i mundësive për mënyrat fleksibile të të mësuarit në arsimin e lartë, duke përfshirë procedurat për njohjen e mësimit paraprak.

Ne gjithashtu kërkojmë nga Grupi Pasues për prezantimin e të dhënave të krahasueshme mbi lëvizshmërinë e stafit dhe të studentëve si dhe për gjendjen sociale dhe ekonomike të studentëve në vendet pjesëmarrëse si bazë e mbështetjes së ardhshme dhe raportimi me kohë për Konferencën Ministrore. The future stocktaking duhet të merr parasysh dimensionin social siç është përmendur më lartë.

IV. Përgatitja për 2010

Për të ndërtuar arritjet në Procesin e Bolonjës, ne aspirojmë ta ndërtojmë Fushën Evropiane të Arsimit të Lartë në bazë të parimeve të cilësisë dhe transparencës. Ne duhet ta mbajmë trashëgiminë tonë dhe diversitetin kulturor duke kontribuar në një shoqëri me njohuri bazë. Ne zotohemi në mbështetjen e parimit të përgjegjësisë publike për arsimin e lartë në kontekst të shoqërive komplekse moderne. Sikurse arsimi i lartë që është i vendosur në udhëkryqet e kërkimeve, arsimit dhe inovacionit, ajo është gjithashtu edhe

konkurrencë kyçe Evropiane. Derisa ne po i afrohemi vitit 2010, ne duhet të ndërmarrim masa për të siguruar që institucionet e arsimit të lartë gëzon autonominë në zbatimin e reformave të dakorduara dhe ne njohim nevojën për financimin e qëndrueshëm të institucioneve.

Fusha Evropiane e Arsimit të Lartë është e përbërë nga tri cikle, ku secili nivel ha funksionin e përgatitjes së studentëve për tregun e punës, për ndërtimin e kompetencave të mëtutjeshme dhe për qytetari aktive. Korniza për kualifikime, struktura e dakorduar për standardet Evropiane dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë dhe njohjen e gradave dhe periodat e studimit gjithashtu janë karakteristikat kyçe të strukturës të EHEA.

Ne miratojmë strukturën pasuese të bërë në Berlin, me përfshirjen e Education International Pan-European Structure, Shoqata Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe UNICE si anëtare te reja konsultative të Grupit Pasues.

Përderisa Procesi i Bolonjës çon në krijimin e EHEA, ne duhet të marrim në konsideratë aranzhimet e përshtatshme të nevojshme për të mbështetur zhvillimet e vazhdueshme edhe pas vitit 2010, dhe kërkojmë nga Grupi Pasues që ti shqyrtojë këto çështje.

Ne do ta mbajmë Konferencën e ardhshme ministrore në Londër në vitin 2007.